



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2623, datë 09.10.2015

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 09.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz””

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Shkronja g) dhe gj) e nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe neni 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**), i ndryshuar;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.02.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”;

4. VKM Nr. 635, datë 15.7.2015 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar;
5. VKM Nr. 468, datë 30.5.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar.
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz”;
2. Dokumenti për këshillim publik “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz””;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Dokumenti për këshillim publik “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz”” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor përkatës.
2. Hartimi i dokumentit është bazuar në pikën 2 të nenit 65, pikën 1 dhe 2 të nenit 68 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.02.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, VKM Nr. 635, datë 15.7.2015 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, VKM Nr. 468, datë 30.5.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”, i ndryshuar.
3. Vendimi Nr.2614, datë 10.09.2015 i KD të AKEP, për “Anullimin e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2570, datë 22.05.2015, për “Miratimin e përfundimit të këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2110-2170 MHz brezi –IMT” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre””
4. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën Nr.2480/2, datë 24.07.2015 (prot. i AKEP Nr.644/10, datë 27.07.2015) kërkon nevojën e konsultimit të

elementëve të shtuar (ndryshimet e miratuara në VKM-në nr. 1252, datë 10.9.2008) me palët e interesuara në procesin e propozuar nga ana jonë për dhënien në përdorim të këtij brezi,

5. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën Nr.3859/1 prot., datë 08.09.2015 (prot i AKEP Nr.644/7, datë 08.09.2015) njofton AKEP se nuk miraton propozimin e paraqitur me shkresën Nr.644/8, datë 25.05.2015.
6. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën nr.4508/1 prot., datë 06.10.2015 (prot. i AKEP nr.644/5, datë 06.10.2015) me lëndë, “Përgjigje shkresë Suaj nr. 644/24 prot., datë 28.09.2015, mbi procesin e këshillimit për përdorimin e brezit të frekuencave 1900 - 1980 MHz, brezi IMT” bazuar në pikën 2 të nenit 68 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, dhe shprehet se mbetet në pritje të ridërgimit të propozimit nga ana jonë.
7. Qëllimi rregullator i konsultimit publik mbi dhënien në përdorim të këtyre frekuencave është:
 - të nxisë një konkurrencë sa më efektive në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre;
 - të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave;
 - të përcaktojë procedurën e konkurrimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore për këtë qëllim,
 - të përcaktojë numrin e autorizimeve individuale,
 - të njohë çmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar si dhe
 - të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative dhe Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave të brezave 1900-1980 MHz, 2500-2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz” sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Periudha e këshillimit publik fillon nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP dhe është 30 ditë.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____

NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

MBI

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FREKUENCAVE TË BREZAVE

1900-1980 MHz, 2500 - 2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz

I. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP,

a) Bazuar në:

- shkronja g) dhe gj) të nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe neni 68 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
- VKM Nr. 635, datë 15.7.2015 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.09.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.

b) Me qëllim:

- përmbushjen me sukses të politikës së zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike si dhe,
- nxitjen e një konkurrence sa më eficiente në tregun e komunikimeve elektronike dhe përdorimin sa më të frytshëm të frekuencave në rastet e kufizimit të tyre;

nis këshillimin publik për dhënie të drejtash përdorimi të frekuencave të brezave 1900-1980 MHz, 2500 - 2690 MHz dhe kushtet e përdorimit të brezit 3400-3800 MHz.

II. Synimi i AKEP është:

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve shqiptarë dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, përdorimin efektiv të spektrit si dhe përmbushjen e objektivave rregullatore.

III. Burimet e spektrit:

- 1. Të drejtat e përdorimit parashikuar të jepen në brezat 1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçftuar 1915-1920 MHz.**

a) Kushtet e përdorimit:

Në Planin Kombëtar të Frekuencave (dhe brenda CEPT) ky brez është përcaktuar si përdorim kryesor për IMT. Kjo përfshin IMT-2000 dhe IMT – të avancuar. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e “Electronic Communications Committee”- ECC/DEC/ (06)01 - “Përdorimi i harmonizuar i brezave 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz për rrjetet e komunikimeve mobile/fix (MFCN) duke përfshirë sistemet tokësore IMT”, rekomandimin ERC/REC (01)01 dhe standartin ETSI - EN 301 908.

b) Bazuar në sasinë e spektrit (2x10 MHz spektër i çiftuar 1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915-1920 MHz) AKEP përpara marrjes së vendimeve për vazhdimin e këtij procesi do të vlerësojë opinionin e të interesuarve për përdorimin e këtij spektri lidhur me çështjet e mëposhtme:

i. Numri i pritshëm i të drejtave të përdorimit

AKEP mendon se numri maksimal i të drejtave të përdorimit është 2 (dy) me nga 5 MHz secila për spektrin e çiftuar (1970-1980 MHz - çiftuar me 2160-2170 MHz) dhe 1 (një) e drejtë përdorimi 5 MHz për spektrin e paçiftuar 1915-1920 MHz.

Mendimi juaj për këtë vlerësim të AKEP.

ii. *Bazuar mbi këtë propozim cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi?*

Mendimi juaj për këtë çështje.

iii. *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave të Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, parashikon përfshirjen edhe të mënyrës së pagesës së autorizimit individual në Dokumentin e Tenderit.*

Mendimi juaj lidhur me mënyrën e pagesës dhe aplikimin e pagesës me këste në këtë procedurë .

iv. *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.7.2015 parashikon se në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e pagesave pa cënuar të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.*

Mendimi juaj për kalendarin e pagesave.

v. Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit?

Mendimi juaj për këtë çështje.

vi. Procedura e konkurrimit publik

Për përzgjedhjen e fituesve do të aplikohet procedura e tenderit publik, "Procedurë e hapur", përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2008 "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave", i ndryshuar.

Mendimi juaj për këtë çështje.

vii. Kushti i mbulimit

AKEP në lidhje me kriteret e mbulimit me shërbim në shkallë gjeografike mendon të aplikojë për sipërmarrësit që nuk e kanë një autorizim për përdorimin e frekuencave të këtyre brezave ose nuk kanë ngritur rrjete që të mundësojnë ofrimin e shërbimeve broadband, sipas tabelës se mëposhtme:

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shënime
Deri në fund të 6 mujorit të parë	Jo më pak se 35% të territorit
Deri në fund të 12 muajve	Jo më pak se 65% të territorit
Deri në fund të 18 muajve	Jo më pak se 85% të territorit

Mendimin tuaj për këtë çështje.

viii. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit

AKEP mendon që kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Mendimi juaj për këtë çështje.

2. Të drejtat e përdorimit që janë parashikuar të jepen në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz.

a) Kushtet e përdorimit:

Në Planin Kombëtar të Frekuencave (dhe brenda CEPT) ky brez është përcaktuar si përdorim kryesor për TRA-ECS. IMT është konsideruar si pjesë e TRA-ECS. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e “Electronic Communications Committee”-ECC/DEC/(02)06 dhe ECC/DEC/ (05)05, me Vendimin e Komisionit të 13 Qershorit 2008 “Mbi harmonizimin e brezit të frekuencave 2500-2690 MHz për sistemet tokësore me aftësi për të siguruar shërbimet e komunikimeve elektronike në Komunitet” me Rekomandimin e Komitetit ECC/REC (11)05 “Planifikimi dhe koordinimi i frekuencave për sistemet tokësore për rrjetet e komunikimit mobile/fix (MFCN), me aftësi për të siguruar shërbimet e komunikimeve elektronike në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz, rekomandimin ERC/REC (01)01, standartin EN 301 908 dhe EN 302 544.

b) Bazuar në dokumentat e mësipërme, raporte të CEPT dhe eksperiencat e vendeve të tjera në administrimin e këtij brezi, 2500-2690 MHz, AKEP propozon që:

i. Brezat 2500 – 2570 MHz i çiftuar me 2620 – 2690 MHz do të alokohen për mënyrën e operimit FDD ku brezi më i ulët duhet të jetë i alokuar për transmetuesin e lëvizshëm brenda brezit më të ulët të frekuencave dhe transmetuesi bazë brenda brezit të sipërm ku blloqet e alokuara të frekuencave do të jenë shumëfisha të 5 MHz.

Mendimi juaj për këtë çështje.

ii. Brezi 2570 – 2620 MHz do të alokohet ose për mënyrën e operimit TDD ose FDD ku blloqet e alokuara të frekuencave do të jenë shumëfisha të 5 MHz.

Mendimi juaj për këtë çështje.

iii. AKEP mendon që sasia e spektrit për të drejtë përdorimi të jetë 2x5 MHz për brezin e çiftuar dhe 5 MHz për brezin e paçiftuar. Ky propozim bëhet për mundësinë teknike të shfrytëzimit dhe për të krijuar mundësinë që cdo i interesuar për përdorimin e këtij spektri të jetë pjesë e garës pamvarësisht nga kapacitetet e tij. Dmth do të jenë 6 të drejta 2x5 MHz në spektrin e çiftuar dhe 6 të drejta 5 MHz në spektrin e paçiftuar. (shih tabelën e ndarjes në blloqe).

Mendimi juaj për këtë çështje.

iv. Bazuar mbi këtë propozim cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi?

Mendimi juaj për këtë çështje.

v. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave të

Zhvillimit të Tenderit Publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, parashikon përfshirjen edhe të mënyrës së pagesës së autorizimit individual në Dokumentin e Tenderit.

Mendimi juaj lidhur me mënyrën e pagesës dhe aplikimin e pagesës me këste në këtë procedurë .

vi. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.635, datë 15.7.2015 parashikon se në rastin e aplikimit të pagesave me këste, ofertuesi paraqet bashkë me ofertën dhe propozimin për kalendarin e pagesave pa cënuar të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.

Mendimi juaj për kalendarin e pagesave.

vii. Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit?

Mendimi juaj për këtë çështje.

viii. Procedura e konkurrimit publik

Për përzgjedhjen e fituesve do të aplikohet procedura e tenderit publik, “Procedurë e hapur”, përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

Mendimi juaj për këtë çështje.

ix. Kushti i mbulimit

AKEP në lidhje me kriteret e mbulimit me shërbim në shkallë gjeografike mendon të aplikojë për sipërmarrësit që nuk e kanë një autorizim për përdorimin e frekuencave të këtyre brezave ose nuk kanë ngritur rrjete që të mundësojnë ofrimin e shërbimeve broadband, kushtet sipas tabelës se mëposhtme:

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shënime
Deri në fund të 6 mujorit të parë	Jo më pak se 20% të territorit
Deri në fund të 12 muajve	Jo më pak se 35% të territorit
Deri në fund të 18 muajve	Jo më pak se 50% të territorit

Mendimi juaj për këtë çështje.

x. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit

AKEP mendon që kohëzgjatja e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Mendimi juaj për këtë çështje.

Argumentat nëse keni ndonjë çështje tjetër për t'u marrë në konsideratë.

NDARJA NE BLOQE NE BREZIN 2500-2690 MHZ

Bloqet FDD Uplink

TDD ose FDD

Bloqet FDD Downlink

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	1'	2'	3'	4'	5'	6'	7'	8'	9'	10'	11'	12'	13'	14'
2500	2505	2510	2515	2520	2525	2530	2535	2540	2545	2550	2555	2560	2565	2570	2575	2580	2585	2590	2595	2600	2605	2610	2615	2620	2625	2630	2635	2640	2645	2650	2655	2660	2665	2670	2675	2680	2685

Spektri i çiftuar blloqet 1-14 FDD Uplink me blloqet 1'-14' FDD downlink

Spektri i paciftuar blloqet 1-10 TDD ose FDD

3. Spektri 3400-3800 MHz.

Brezi 3400- 3600 MHz dhe brezi 3600-3800 MHz mbështet shërbimet mobile me brez të gjerë. (Plani Kombëtar i Frekuencave, aplikime BWA, bazuar në ERC/REC 14-03; EN 302 217; EN 302 326; EN 302 623; EN 302 774 EN 301 443, ECC/DEC/ (11)06).

Në disa vende ky brez është përdorur për të ofruar shërbime broadband të bazuara në teknologjinë WiMAX. Duhet theksuar se nuk ka gjetur përhapje të gjerë për shkak të zhvillimit të shpejtë të disa teknologjive të tjera që ofrojnë cilësi më të lartë shërbimi të ofruar, kosto ndërtimi rrjeti më të vogla krahasuar me këtë teknologji, shumëllojshmëri të kufizuar të shërbimeve të ofruara, kapacitete më të larta transmetimi etj.

Meqënëse ky brez pritet të liberalizohet nga pikëpamja e teknologjisë dhe shërbimeve të ofruara, paraprkasht AKEP mendon të marrë një opinion nga palët e interesuara me qëllim që në hartimin e strategjive dhe planeve në shfrytëzimin e këtij spektri në të ardhmen të jetë sa më real dhe efektiv referuar interesave të tregut.

Ky brez është përcaktuar për përdorimin e sistemeve IMT në pjesën më të madhe të vendeve anëtare të CEPT në përputhje me Vendimin e ECC Nr. 5.430A. (ECC/DEC/ (11)06) “Mbi përdorimin e brezit 3400- 3800 MHz për shërbimet mobile me brez të gjerë” e ndryshuar, për t’iu përgjigjur kërkesave për përdorimin në të ardhmen, të sistemeve IMT me gjerësi brezi të madhe dhe me fuqi emisioni të lartë.

Raporti 100 ECC dhe Raporti ITU-R M.2109 kanë treguar që nuk ekziston përputhshmëri teknike midis operimit FSS dhe MS në të njëjtën zonë gjeografike dhe kjo kërkoi që distanca e ndarjes së kanaleve të përbashkët të jetë e madhe. Gjithashtu duke konsideruar studimet e bëra nga JTG për sistemet IMT sic dhe reflektohen në Raportin ITU-R S.2368, parametrat e reja të IMT nuk ndryshojnë përfundimet e studimeve të mëparshme.

Siç është theksuar nga RSPG (Radio Spectrum Policy Group - High-level advisory group that assists the European Commission in the development of radio spectrum policy) mbi objektivat e politikave të përbashkëta për WRC-15, brezi i frekuencave 3 600-4 200 MHz, jashtë Evropës, luan një rol të rëndësishëm për komunikimet satelitore. Kjo mund të kufizojë mundësinë e përdorimit në të gjithë botën të këtij brezi për IMT.

Harmonizimi dhe matjet rregullatore që do të përshtaten për këtë brez frekuencash do të varen nga mbështetja që do t’i jepet këtij brezi për IMT nga vendet jashtë Evropës.

- a) Bazuar në dokumentat e mësipërme, si dhe Vendimin e Komisionit 2008/411/EC mbi harmonizimin e brezit 3400-3800 MHz, i ndryshuar me Vendimin e Komisionit 2014/276/BE datë 14 maj 2014, rregulloreve për implementimin e këtij Vendimi, AKEP propozon që:

Sasia e spektrit për të drejtë përdorimi të jetë me blloqe shumëfishe të 5 MHz ose 10 MHz. Sasia e përdorur 10 MHz do të ishte më e përshtatshme për brezin 3.4 GHz.

Brezi 3400 – 3600 MHz do të alokohet ose për mënyrën e operimit TDD ose FDD ku blloqet e alokuara të frekuencave do të jenë shumëfishta të 5 MHz:

- Në rastin e operimit TDD, blloqet do të jenë 5 MHz duke filluar nga kufiri më i ulët 3400 MHz. Nqs blloqet do të duhen të kompesohen për të mundësuar përdorimin nga përdorues të rinj, rasteri duhet të jetë 100 kHz. Blloqet më të ngushta mund të identifikohen si fqinje me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimin e plotë të spektrit. Gjithashtu duhet të theksohet se TDD në një rast ekstrem mund të mbulojë operimin downlink. Blloqet e shumëfishta fqinje prej 5 MHz mund të kombinohen për të përfituar kanal më të gjerë.




Figura 1:- Brezi 3400-3600 MHz i alokuar sipas mënyrës së operimit TDD.

- Në rastin e operimit FDD, blloqet do të jenë 5 MHz duke filluar nga kufiri më i ulët 3410 MHz. Nën brezat 3410-3490 MHz përdoren për Uplink dhe nën brezat 3510-3590 MHz përdoret për downlink. Duplex Gap është 20 MHz (3490-3510 MHz). Nqs blloqet do të duhen të kompesohen për të mundësuar përdorimin nga përdorues të rinj, rasteri duhet të jetë 100 kHz. Blloqet më të ngushta mund të identifikohen si fqinje me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimin e plotë të spektrit. Blloqet e shumëfishta fqinje prej 5 MHz mund të kombinohen për të përfituar kanal më të gjerë.




Figura 2:- Brezi 3400-3600 MHz i alokuar sipas mënyrës së operimit FDD.

- Brezi 3600- 3800 MHz do të alokohet për mënyrën e operimit TDD, bazuar në blloqe 5 MHz duke filluar nga kufiri më i ulët 3600 MHz. Nqs blloqet do të duhen të kompesohen për të mundësuar përdorimin nga përdorues të rinj, rasteri duhet të jetë 100 kHz. Blloqet më të ngushta mund të identifikohen si fqinje me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimin e plotë të spektrit. Gjithashtu duhet të theksohet se TDD në një rast ekstrem mund të mbulojë operimin downlink. Blloqet e shumëfishta fqinje prej 5 MHz mund të kombinohen për të përfituar kanal më të gjerë.




Figura 3:- Brezi 3600-3800 MHz i alokuar sipas mënyrës së operimi TDD.

Sasia minimale e spektrit për të drejtë përdorimi të jetë 20 MHz.

Pyetja 1:

Cilat janë aplikimet që mund të ofrohen në brezat e frekuencave 3400-3600 MHz në vendin tonë psh:

- mobile, shërbim fiks, shërbim fiks-satelitor, shërbim broadcast-satelitor, shërbim i lëvizshëm satelitor etj)

Pyetja 2:

Cilat nga aplikimet (p.sh PPDR, IMT, Broadband Wireless Access, VSAT etj) dhe teknologjitë përkatëse (p.sh Wi-Fi, WiMAX, CDMA, W-CDMA etj) mund të autorizohen për përdorim në brezin 3400-3600 MHz? Cili brez frekuence, apo ndarje brezi mund të përdoret për çdo aplikim?

Pyetja 3:

A mund të përshkruani karakteristikat e sistemit të aplikimit që mendoni si primar duke përfshirë detaje si “spectrum emission mask, in-band transmission power”, “bandwidth”, “receiver performance” etj.

Pyetja 4:

Në se në brezin 3400-3600 MHz do të kemi aplikime të shumëfishta, si mund të arrijmë të sigurojmë sharing/compatibility midis këtyre aplikimeve?

Pyetja 5:

AKEP ka për të planifikuar në të ardhmen dhënien në përdorim të këtij brezi bazuar në përcaktimet e dhëna më sipër në këtë dokument përfshi ndarjen në blloqe, mënyrën e operimit, etj. Cili është opinionimi juaj për këtë çështje? Sasia minimale dhe maksimale e spektrit të mundshëm për aplikimin primar që mendoni të zbatoni?

Pyetja 6:

A mund të na përshkruani karakteristikat e sistemit për sistemet LTE dhe WiMAX, duke përfshirë informacion lidhur me “spectrum emission mask”, “in-band transmission power”, “bandwidth”, “receiver performance” etj.

Pyetja 7:

A keni ndonjë pritshmëri ose sygjërim për dhënien në përdorim të këtij brezi?